REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.499 Prot

Maliq, më 02.02.2026

VENDIM
Nr. 21, datë 30.01.2026

"Mbi mbështetjen e aktivitetit 'Night to Shine' ("Natë për të Shkëlqyer") për personat me aftësi të kufizuara"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, I ndryshuar, neni 8 neni 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma "b", neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*"pika "c" ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, ligjit nr. 121/2016, "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*, ligjit nr. 93/2014, "*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"*, si dhe politikave vendore të Bashkisë Maliq për përfshirjen sociale dhe mbështetjen e grupeve në nevojë, Bashkia Maliq, në bashkëpunim me organizatën *"Duart që Sigurojnë"*, do të mbështesë realizimin e aktivitetit social *"Night to Shine"*, i cili synon promovimin e dinjitetit, përfshirjes sociale dhe mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër Këshilli Bashkiak i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë mbështetjen e aktivitetit "Night to Shine" ("Natë për të Shkëlqyer") për personat me aftësi të kufizuara, i cili organizohet nga organizata "Duart që Sigurojnë".

2.Të miratojë përdorimin e fondit në vlerën 120,000 (njëqind e njëzet mijë) lekë, nga buxheti i Bashkisë Maliq, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve që do të kryhen për realizimin e aktivitetit "Night to Shine", ku procedurat përkatëse financiare dhe administrative do të kryhen nga vetë Bashkia Maliq, në përputhje me legjislacionin në fuqi . Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2026, si më poshtë:

	Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
Pakesim	00	05	01110	609	Fondi Rezerve	120 000
Shtese	00	05	01110	602	Sherbim (marrje me qera skena fonia dhe aksesore te ndryshem)	120 000

3.Shuma e miratuar nuk përbën transferim fondesh në favor të organizatës "Duart që Sigurojnë", por përfaqëson kontribut financiar të Bashkisë Maliq për mbështetjen e këtij aktiviteti me karakter social dhe komunitar.

4.Ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015"*Për vetëqeverisejn vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 23 vota
Vota Pro 23
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ